



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:162226

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05501927

**Ac.nr.6852/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Malsor Kryeziu, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Y.R. nga fshati P..., Komuna Gjilan, të cilën e përfaqëson me autorizim K.A.S., avokat me seli në Komuna Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën e përfaqëson Burim Maliqi, për kompensimin e diferencës në pagë kualifikimin-gradimin, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.966/2021 datë 19.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.966/2021 datë 19.08.2022, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.966/2021 datë 19.08.2022, ka vendosur si vijon:

*“... I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Y.R. nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit dhe OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses në emër të diferencës në pagë, për punonjësin me licencim/fakultet, për periudhën kohore nga data 16.06.2018 deri më 31.07.2022, për 50 muaj nga 55.35 € në muaj, t’ia paguaj shumën prej 2, 767.50€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 22.07.2021 e deri në*

*pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.*

*II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit, që paditëses t'iu paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumë prej 260 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë...”*

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor e paditura DKA Gjilan, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës material, me propozim Gjykatës së Apelit ta aprovojë ankesën ta prishë aktgjykimin e atakuar ose çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesa nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Y.R. nga Komuna Gjilan, me datë 22.07.2021, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për kompensimin e diferencës në pagë kualifikimin-gradimin.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesore me datë 19.08.2022, dhe pas administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykim C.nr.966/2021 datë 19.08.2022, me të cilin ka vendosur që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar si vijon: *“...Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësja dhe lartësisë së saj, ka zatur dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt.18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, konkretisht nenin 7 paragrafi 1.4 dhe nenin 35 par. 7 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi. Me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017, në parashihet se:”Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë pika 1.4 “Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeqare 27 % e pagës bazë.”, ndërsa në rastin konkret e njëjta i plotëson të gjitha kushtet për kompensim sipas dispozitave lartcekura. Gjykata në bazë të bazë të dispozitave të lartcekura dhe pas vërtetimit të faktit se paditësja si*

*mësimdhënëse e ciklit klasor, e paisur me licencë të karrierës, me gradën e studimeve Bachelor, e punësuar në SHFMU “Skendërbeu” ka lidhur kontratë pune me të paditurën nga 01.09.2015 dhe vazhdon të punoj edhe më tutje në të njëjtën pozitë të njëjtës në emër të pagës për gardim-licencim për periudhën kohore nga data 16.06.2018 deri më 31.07.2022, duhet t’i paguhet shuma prej 2, 767.50 Euro andaj nga të lartëcekurat gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se nga kontrata e punës për mësimdhënëse në kohë të pacaktuar me numër protokoli 711 të datës 01.09.2015, vërtetohet fakti se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në SHFMU “Skendërbeu” në fshatin P..., dhe e njëjta që nga data 01.09.2015 në këtë shkollë punon si mësimdhënëse e mësimit klasor. Nga Kërkesa e datës 16.06.2021, vërtetohet fakti se paditësja paraprakisht i është drejtuar të paditurës në procedurës administrative me kërkesë për kompensimin e diferencës në pagë – licencim. Nga Licenca e mësimdhënësit me numër 100000 e datës 11.09.2012, vërtetohet fakti se paditësja është e pajisur me licencë të karrierës, e lëshuar me datë 11.09.2012. Nga Vërtetimi me numër 519 i datës 15.08.2020, vërtetohet fakti se paditësja është punëtore në shkollën fillore “Skendërbeu”, me detyra të punës arsimtare e mësimit klasor. Nga Lista e pagave EM00118551, vërtetohet fakti se paga bazë e paditëses është 421 Euro. Nga Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, - Fakulteti i Edukimit - Qendra në Gjilan, i datës 12.10.2016, vërtetohet fakti se paditësja posedon diplomë për mbarimin e studimeve dhe ka fituar gradën Baçelor i Programit Fillor, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Lidhur me shumën e kompensimit të diferencës për licencim, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit mësimdhënësit... ndërsa në pikën 1.3 të po këtij nenit thuhet: mësimdhënëse me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27% e pagës bazë... ndërsa në pikën 1.4 thuhet: “mësimdhënëse me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/ master dhe doktrate 35% e pagës bazë”, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, dhe e datës 22.01.2021, dhe mbi këtë bazë kërkesëpadia është e bazuar.*

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i shkallës së parë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht me Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar me nenin 35, paragrafi 5, 7 dhe 9 brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare nuk qëndron pasi që Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të shujtave dhe kualifikim i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar të drejtën materiale lidhur me afatshmërinë e padisë, gjegjësisht se kërkesa e paditësve nuk është parashkruar, për shkak se në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, me nr. 03/L-212 i dt. 01.11.2010, përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës ”* duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe e cila ishte në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik, rrjedh se padia e paditëses është e lejuar dhe e ushtruar brenda afatit kohor.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 328 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet ankimore të paditëses dhe të paditurës, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim dhe peshë për një vendim ndryshe, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6852/2022 datë 25.03.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**